



QKSS

Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë

LEGJITIMIMI I MISIONEVE TË HUAJA:
DEKONSTRUKTIMI I PERCEPTIMEVE
TË QYTETARËVE NDAJ EULEX-IT
NË KOSOVË



Publikuar nga: Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS)

Autore: Emma-Louise Rose

Ky raport në formën e tij origjinale është shkruar në gjuhën angleze

© Të gjitha të drejtat janë të rezervuara nga Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë. Të drejtat dhe pronësia intelektuale mbrohen nga Ligji Nr. 04/L-065 për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në sisteme elektronike apo të transmetohet në çfarëdo forme apo mjete elektronik, mekanik apo mjet tjetër, pa lejen me shkrim të botuesit. Nuk lejohet shfrytëzimi komercial i asnjë materiali të botuar nga Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS) pa lejen me shkrim të QKSS-së. Ju lutemi të kontaktoni: info@qkss.org ose +383 38 221 420.



QKSS

Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë

LEGJITIMIMI I MISIONEVE TË HUAJA:

DEKONSTRUKTIMI I PERCEPTIMEVE
TË QYTETARËVE NDAJ EULEX-IT
NË KOSOVË

PËRMBAJTJA

KONTEKSTI I PRANISË SË EULEX-IT NË KOSOVË	6
PERCEPTIMI PUBLIK VIS-À-VIS EULEX-IT	9
PËRFUNDIM	16
BIBLIOGRAFIA	17

PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME

EULEX-i është i pranishëm në Kosovë për më shumë se një dekadë (që nga viti 2008), me qëllim krijimin dhe përmirësimin e institucioneve të sundimit të ligjit, pa korrupsion dhe ndërhyrje politike dhe duke përqafuar standardet e njohura ndërkombëtarisht. EULEX-i shoqërohet nga misione të tjera ndërkombëtare në Kosovë, gjegjësisht KFOR-i i cili ka mandatin të garantojë mbrojtje dhe siguri për qytetarët e Kosovës. Nga ana e BE-së, EULEX-i është misioni më i madh civil që ajo ka ndërmarrë ndonjëherë në përpjekje për të forcuar atë që konsiderohet si pika më e dobët e BE-së: politika e jashtme dhe e sigurisë.

Përkundër pranisë së tij të gjatë, EULEX-i nuk e ka fituar besimin e qytetarëve të Kosovës. Barometri Kosovar i Sigurisë (BKS) që punohet çdo vit nga QKSS ka matur në vazhdimësi besimin që kanë qytetarët e Kosovës ndaj misionit dhe ka gjetur që shifrat janë vazhdimisht të ulëta, krahasuar me institucionet e tjera vendore dhe ndërkombëtare. Mungesa e besimit, dhe rrjedhimisht e mbështetjes, nga publiku me sa duket buron nga shumë fusha të ndryshme, veçanërisht neutraliteti i BE/EULEX-it për çështjen e pavarësisë së Kosovës (për shkak të mosnjohjes nga 5 shtete anëtare) dhe dështimi për të kryer misionin e tij. Bazuar në matjet sasiore të BKS, mungesa e besimit ka mbetur mjaft e qëndrueshme ndër vite, me të gjitha statistikatat e dhëna brenda 15% të njëra-tjetrës (midis 16% dhe 31%), ku niveli më i ulët i besimit u regjistrua në 2015. Kjo solli në dyshim legjitimitetin dhe mbështetjen e publikut për misionin.

Në këtë punim shqyrtohen vitet kur BKS ka matur besimin e publikut ndaj misionit dhe ngjarjet përkatëse lidhur me misionin që kanë ndodhur në ato vite dhe ka analizuar arsyet e dhëna për mungesën e besimit si në edicionet e ndryshme të BKS-së ashtu edhe në burime të tjera, siç janë revistat akademike, studimet e kryera nga studiues të tjerë dhe raportet e dorës së parë nga personat që kanë qenë të përfshirë në mision. Gjetjet kryesore ishin që publiku asnjëherë nuk ka pasur besim të madh ndaj EULEX-it, por prapë e sheh BE-në si një aspekt pozitiv meqë dëshiron që Kosova të bëhet shtet anëtar. Ekzistojnë gjithashtu dallime rajonale dhe etnike në nivelet e besimit, të cilat mund të shpjegohen me çështjet e sovranitetit dhe veprimtarisë së EULEX-it në treva të ndryshme të Kosovës. Në përgjithësi, ky punim vë në pikëpyetje nëse EULEX-i ka ende mandat të mbetet në Kosovë duke pasur parasysh se fitimi i besimit, si të shqiptarëve të Kosovës ashtu edhe të serbëve të Kosovës, duket një detyrë pothuajse e pamundur, dhe për faktin që ka bërë pak për të përmirësuar situatën në Kosovë përkundër narrativit të tyre publik duke pretenduar të kundërtën.

KONTEKSTI I PRANISË SË EULEX-IT NË KOSOVË

Sistemi i drejtësisë penale në Kosovë ka kaluar nëpër ndryshime të shumta në një periudhë relativisht të shkurtër kohore. Kur Kosova ishte pjesë e Republikës Federative Socialiste të Jugosllavisë, ndërmjet viteve 1974 dhe 1989 ajo kishte autonomi të madhe – pothuajse ekuivalente me nivelin e gjashtë republikave – me shumë institucione të pavarura. Mirëpo, gjatë pushtetit të Slobodan Milošević-it autoriteteve serbe iu dhanë kompetenca të plota në Kosovë, ngjashëm me statusin e saj para vitit 1974, si rezultat i suprimimit të autonomisë së saj në 1989. Kjo rezultoi në shtypjen sistematike të shqiptarëve të Kosovës që iu nënshtruan një segregacioni të madh të kombinuar me forma të ndryshme të dhunës strukturore.

Pas luftërave në Jugosllavi që rezultuan me shpërbërjen e saj dhe luftën e Kosovës të viteve 1998-1999, Kosova u klasifikua si protektorat ndërkombëtar dhe aty u vendos një mision i OKB-së në përpjekje për të ruajtur stabilitetin në rajon pas Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurisë të Kombeve të Bashkuara (KSKB). Misioni i Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) ende vepron në Kosovë së bashku me EULEX-in, megjithëse pati debate kur EULEX-i filloi punën së pari lidhur me mbivendosjen e detyrave, ku EULEX-i mori përsipër shumë nga detyrat e UNMIK-ut.¹

EULEX-i, ose Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë, është misioni më i madh civil i BE-së dhe filloi punën në shkurt 2008 menjëherë pasi Kosova shpalli pavarësinë dhe u bë plotësisht operacional në prill 2009. Megjithëse EULEX-i kishte si qëllim fillestar udhëheqjen e Kosovës nëpër një periudhë kalimtare të pavarësisë së mbikëqyrur, ai u ngrit duke respektuar Rezolutën 1244 të KSKB-së, që nënkuptoi se ai do të duhej të mbetet neutral për sa i përket Kosovës si shtet i pavarur.² Baza e tij ligjore plotësohet me ftesën formale të institucioneve të Kosovës që formalisht e ftojnë EULEX-in çdo të dytin vit përmes letërkëmbimit zyrtar. Ndërsa Kosova është njohur nga mbi 100 vende të botës dhe gjithashtu është bërë anëtare e

1 Erika De Wet, 'The Governance of Kosovo: Security Council Resolution 1244 and the Establishment and Functioning of Eulex'. *The American Journal of International Law*, vol 103 (2009), pp 83-96.

2 Martina Spornbauer, 'EULEX Kosovo: The Difficult Deployment and Challenging Implementation of the Most Comprehensive EU Operation to Date'. *German Law Journal*, vol 11 no 8 (2010), pp 769-802.

dhjetëra organizatave ndërkombëtare, njohja e saj nga BE-ja është penguar shumë nga mungesa e konsensusit dhe refuzimi nga pesë shtete anëtare të saj për të vepruar si 22 anëtarët e tjerë.

Sipas deklaratës së misionit, EULEX synon të adresojë 6 koncepte kryesore: qëndrueshmërinë, llogaridhënien, shumë-etnitetin e policisë, drejtësinë dhe shërbimin doganor, lirinë e sistemit të drejtësisë nga ndërhyrjet politike dhe që në sistemin e drejtësisë të rrenjosë standarde të njohura ndërkombëtarisht. Në përgjithësi, ai synon "evropianizimin" e institucioneve të Kosovës për sundimin e ligjit.³ Pavarësisht qëndrimit neutral të EULEX-it rreth statusit, duhet të pranohet që institucionet e sundimit të ligjit që ai kishte për synim t'i përmirësojë janë të lidhura tradicionalisht me, dhe jetike për, aparatën e një shteti të pavarur, dhe Kosova është njohur nga BE-ja si kandidat potencial për anëtarësim në të ardhmen.

Gjatë pranisë së tij në Kosovë, EULEX-i është reformuar disa herë dhe misioni i tij është zgjatur më shumë se një herë. Gjatë periudhës së mandatit 2008-2010, detyrat kryesore të misionit ishin monitorimi, mentorimi dhe këshillimi i autoriteteve të Kosovës në secilën pjesë përbërëse të Sundimit të Ligjit - gjyqësor, polici dhe doganë. Mirëpo, EULEX-i gjithashtu fitoi kompetenca ekzekutive lidhur me krimet e ndjeshme ose të rënda. Sidoqoftë, kjo u zbulua më vonë si dobësi kryesore në misionin e EULEX-it. Ka pasur shqetësime për kompetencat ekzekutive të EULEX-it kur kombinohen me mungesën e llogaridhënies. Siç thuhet në një kumtesë të politikave nga autorë vendas, populli i Kosovës nuk mund të mbikëqyrë ose të kontrollojë veprimet e EULEX-it, kundrejt mungesës së llogaridhënies demokratike nga Brukseli pas vendosjes së misionit.⁴

Koha e EULEX-it në Kosovë nuk ka qenë plotësisht paqësore dhe është përballur me kritika të konsiderueshme. Në vitin 2009, jo shumë kohë pasi misioni kishte marrë formën e plotë, pati protesta të dhunshme në Prishtinë lidhur me marrëveshjen e nënshkruar ndërmjet policisë së EULEX-it dhe Serbisë. Marrëveshja kishte të bënte me bashkëpunimin e EULEX-it me autoritetet serbe në luftimin e të gjitha formave të krimit në Kosovë dhe thuhej se ishte në përputhje me Rezolutën 1244.⁵ Kjo, krahas statusit neutral të EULEX-it, në mënyrë të kuptueshme shkaktoi shqetësim të konsiderueshëm në Kosovë pasi solli në dyshim besnikërinë dhe pozicionin e EULEX-it. Sidoqoftë, protestat e dhunshme që rezultuan nga kjo, duke përfshirë sulme ndaj automjeteve të EULEX-it, konsiderohen të paarsyeshme.

3 EULEX, *Ç'është EULEX-i?*, 2020. < <https://www.eulex-kosovo.eu/?page=1,16>>.

4 KIPRED, *Analizë gjithëpërfshirëse e EULEX-it: Çka më tutje?*, 2013. <http://www.kipred.org/repository/docs/Analiz%C3%AB_Gjith%C3%ABp%C3%ABrfshir%C3%ABse_e_EULEX-it_-_%C3%87ka_m%C3%AB_Tutje_379829.pdf>.

5 Ewa Mahr, 'Local contestation against the European Rule of Law Mission in Kosovo'. *Contemporary Security Policy*, vol 39 issue 1 (2018), pp 72-94.

Në vitin 2010, mandati i EULEX-it u zgjat edhe për dy vjet të tjera, ku objektivat e saj mbetën të njëjta, por zgjatja e dytë në 2012 solli një ulje të numrit të stafit (nga pothuajse 3000 në pikën kulmore të tij në rreth 1600) dhe një ristrukturim të misionit. Ai u nda në dy komponentë: ekzekutiv, i cili merrej me mandatin ekzekutiv të EULEX-it, dhe forcues, i cili synonte të merrej me aspektet e monitorimit, mentorimit dhe këshillimit.⁶ Kjo ndodhi pas një raporti nga Gjykata Evropiane e Auditorëve që solli në dyshim efektivitetin e misionit.⁷ Ky raport me të drejtë vuri në dukje nivelet e larta të korrupsionit që kishin mbetur brenda vendit, ndërhyrjen e vazhdueshme politike dhe dështimin për të arritur përparim në veriun e Kosovës. Ka pasur gjithashtu kritika nga grupet kërkimore lokale në lidhje me personelin e EULEX-it, me shqetësime të shprehura për ndikimin e personelit duke qenë në vend vetëm për një kohë relativisht të shkurtër përpara se të zëvendësohet, dhe se si aftësia e misionit për të qenë efektiv ishte ndikuar negativisht nga mungesa e koordinimit në radhët e stafit të vet, dhe ngurrimi i misionit për të ndjekur rastet që do të 'shkundnin varkën'.⁸

Në 2018, mandati i EULEX-it u zgjat edhe për dy vjet të tjera për atë që shpresohej të ishte hera e fundit. Ai i dha fund shumë prej funksioneve ekzekutive, duke ia dorëzuar çështjet autoriteteve të Kosovës. Sidoqoftë, ai ende bënte monitorimin e shërbimit korrektues, si dhe të shkresave të lëndëve që ishin dorëzuar para dorëzimit të çështjeve. EULEX-i gjithashtu vazhdoi të ofronte mbështetje për policinë e Kosovës dhe ruajti disa përgjegjësi ekzekutive. Përkundër shpresës që EULEX-i do të tërhiqej nga Kosova në vitin 2020, mandati i tij është zgjatuar edhe për një vit tjetër dhe misioni do të mbetet në Kosovë deri në qershor 2021.⁹

Përkundër raporteve të BE-së dhe riorganizimeve të EULEX-it, si dhe një Paneli Shqyrtues për të Drejtat e Njeriut të caktuar për të shqyrtuar misionin e EULEX-it, në sytë e qytetarëve të Kosovës misioni ende shihet si i pasuksesshëm, dhe çdo vit Barometri Kosovar i Sigurisë raporton nivele të ulëta të besimit ndaj misionit. Ky raport do të vazhdojë me analizimin e niveleve të vazhdueshme të mosbesimit ndaj misionit të EULEX-it, meqë mbështetja publike ndaj misionit konsiderohet të jetë aspekt jetik për vazhdimin e çdo misioni ndërkombëtar. Ai gjithashtu do të bazohet në Barometrën Kosovar të Sigurisë dhe burime të tjera duke u orvatuar të përcaktojë arsyet e mosbesimit.

6 EULEX, *Histori e shkurtë për EULEX-in*, 2018. < <https://www.eulex-kosovo.eu/?page=1,44,197>>.

7 European Court of Auditors, *European Union Assistance to Kosovo Related to the Rule of Law*, 2012. < https://www.eca.europa.eu/Lists/ECADocuments/SR12_18/SR12_18_EN.PDF>.

8 Balkans Policy Research Group, *Një dekadë pas EULEX-it*, 2019. < <https://balkansgroup.org/wp-content/uploads/2020/01/Nje-dekade-pas-eulex-it-qasje-e-re-per-ta-permiresuar-sundimin-e-ligjit-ne-kosove.pdf>>.

9 European Western Balkans, *EULEX mandate in Kosovo extended for another year*, 2020. < <https://europeanwesternbalkans.com/2020/07/13/eulex-mandate-in-kosovo-extended-for-another-year/>>.

PERCEPTIMI PUBLIK VIS-À-VIS EULEX-IT

Midis 2012 dhe 2018, periudha që merr në shqyrtim ky punim, besimi ndaj EULEX-it në radhët e qytetarëve kosovarë ishte vazhdimisht i ulët. Ka pasur rënie dhe ngritje të besimit të publikut, me besimin më të madh të raportuar në vitin 2014 dhe me një rënie relativisht të madhe në vitin 2015, por, në përgjithësi, gjatë kësaj periudhe ka pasur pak ndryshime. Kjo mungesë besimi është shqetësuese, duke marrë parasysh që janë qytetarët e Kosovës ata që do të preken nga rezultati i misionit.

Edicioni i parë i Barometrit Kosovar të Sigurisë (BKS) u botua në vitin 2012 dhe solli një raport të dobët të opinionit të publikut kosovar për misionin e EULEX-it.¹⁰ Të pyetur për të vlerësuar kënaqshmërinë e tyre në shkallë të Likert-it nga 1 në 5, ku 1 - shumë i pakënaqur, vetëm 22% e të anketuarve u shprehën të kënaqur me misionin. Përveç kësaj, shumica e të anketuarve shprehën mendimin se EULEX-i ishte i njëanshëm kur krahasohej me KFOR-in.

Është interesante të theksohet se raporti i vitit 2012 u botua pas riorganizimit të misionit, dhe Përfaqësuesja e Lartë e BE-së tha se "EULEX-i është duke bërë një punë të rëndësishme dhe të mirë në mbështetje të sundimit të ligjit në Kosovë".¹¹ Kjo mospërputhje ndërmjet mendimit të Përfaqësueses për mënyrën se si po shkonte misioni dhe kënaqshmërisë së ulët të raportuar nga BKS është edhe më e diskutueshme kur merret parasysh raporti nga Gjykata Evropiane e Auditorëve, që i bën të qarta dështimet e EULEX-it në Kosovë. Për më tepër, kishte mospajtim të gjerë publik me misionin, me qytetarë që argumentonin se EULEX-i nuk kishte bërë asgjë për të luftuar korrupsionin që po ndodhte në nivelet e larta të autoriteteve kosovare, dhe akuzonin EULEX-in që nuk kishin arritur asgjë në veri të vendit. Kjo nxiti përgjigje nga EULEX-i në formën e një fushate mediatike.¹²

Për 2013 deri në 2018, më poshtë është dhënë një grafik me përqindjen e besimit gjatë kësaj periudhe.¹³


10 QKSS, *Barometri Kosovar i Sigurisë*, 2012. <http://www.qkss.org/repository/docs/Kosovo_Security_Barometer_Report_Shqip_935713.pdf>

11 EULEX, *EULEX Mission Extended until June 2014*, 2012. <<https://www.eulex-kosovo.eu/en/news/000368.php>>.

12 Fatmir Aliu, 'EU Kosovo Mission Fights Back Against Critics'. *Balkan Insight*, 14 qershor 2012. <<https://balkaninsight.com/2012/06/14/eulex-fights-back-to-critics/>>.

13 Shifrat janë marrë nga edicioni i tretë i BKS-së në vitin 2012 deri në edicionin e tetë të botuar nga fundi i vitit 2018.

Besimi ndaj EULEX-it (%)



BKS i parë për vitin 2013 solli pak përmirësime lidhur me kënaqshmërinë e publikut me EULEX-in, me vetëm 25% që raportuan se ishin të kënaqur me misionin, gjë që i dha EULEX-it një nga vlerësimet më të këqija nga të gjitha autoritetet e pranishme në Kosovë në atë kohë dhe paraqet një faktor që do të tregojë konsistent përgjatë viteve në vijim.¹⁴ Më vonë në 2013, BKS i dytë i vitit (dhe edicioni i tretë i raportit) gjeti kënaqshmëri prej 31.4% me misionin. Ky BKS gjithashtu matì besimin e publikut ndaj EULEX-it, me 29.2% të të anketuarve që raportuan se kishin besim në misionin e EULEX-it. Për më tepër, vetëm 7.3% e publikut raportuan se kishin kontakte me misionin.¹⁵

Besimi ndaj EULEX-it mbeti i ulët në 2014, me vetëm 31% të të anketuarve që thanë se i besonin misionit. Të anketuarit e BKS raportuan se mosbesimi i tyre ishte për shkak të "kontributit të kufizuar të këtij misioni karshi mbështetjes së dhënë për institucionet e Kosovës për ta parandaluar dhe për ta luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar".¹⁶ Në të vërtetë, edhe ky edicion i BKS-së zbuloi se edhe pasi misioni kishte punuar në Kosovë për gati një dekadë (dhe kjo nuk po përfshin praninë e UNMIK-ut para kësaj), publiku prapë mendonte se kishte nivele të larta korrupsioni në radhët e autoriteteve kosovare, pavarësisht se ky ishte një nga qëllimet kryesore të misionit. Qeve-

14 QKSS, *Barometri Kosovar i Sigurisë, Zërat e Kosovës: Vështrimet dhe Perceptimet*, 2013. <[http://www.qkss.org/repository/docs/Barometri Kosovar i Sigurise Edicioni i Trete 374655.pdf](http://www.qkss.org/repository/docs/Barometri%20Kosovar%20i%20Sigurise%20Edicioni%20i%20Trete%20374655.pdf)>.

15 QKSS, *Barometri Kosovar i Sigurisë, Edicioni i tretë*, 2013. <[http://www.qkss.org/repository/docs/Barometri Kosovar i Sigurise Edicioni i Trete 374655.pdf](http://www.qkss.org/repository/docs/Barometri%20Kosovar%20i%20Sigurise%20Edicioni%20i%20Trete%20374655.pdf)>.

16 QKSS, *Barometri Kosovar i Sigurisë, Edicioni i katërt*, 2014. <[http://www.qkss.org/repository/docs/Barometri Kosovar i Sigurise - Edicioni i katert 515028.pdf](http://www.qkss.org/repository/docs/Barometri%20Kosovar%20i%20Sigurise%20Edicioni%20i%20Katerte%20515028.pdf)>.

ria u pa si më e korruptuar, me 58.7% të të anketuarve që mendonin se ishte 'shumë e korruptuar'. Për më tepër, 72.8% shprehën mendimin se korrupsioni i brendshëm ishte një nga kërcënimet më të mëdha për sigurinë e Kosovës.

Edicioni i pestë i BKS-së në vitin 2015 raportoi se vetëm 16% e të anketuarve i besonin misionit dhe raporti shquan faktin se për herë të parë Prokuroria dhe Gjykatat gëzonin më shumë besim nga qytetarët sesa EULEX-i, duke e lidhur këtë me dështimet e vazhdueshme të EULEX-it për të luftuar korrupsionin dhe me një skandal korrupsioni në fund të 2014 dhe fillim të 2015.¹⁷ Skandali kishte të bënte me pretendimet se tre raste ishin hedhur nga prokurorët e EULEX-it që kishin marrë rryshfet. Në vitin 2015, gazeta e Mbretërisë së Bashkuar The Guardian raportoi për këtë çështje, duke thënë se personi përgjegjës për zbulimin e skandalit, Maria Bamieh, ishte shkarkuar dhe larguar nga misioni¹⁸. U desh një vit që EULEX-i të niste një hetim të brendshëm të pretendimeve. Në mars 2015, raporti kishte marrë formën e plotë dhe konstatoi pretendimet e Bamieh si të pavërteta, megjithëse ngriti pyetje nëse EULEX-i mund të përfundojë me sukses misionin e tij në Kosovë.¹⁹ Ndërsa misioni në Kosovë dështon në arritjen e qëllimeve të veta dhe me sa duket në aspektin e brendshëm vuan nga të njëjtat çështje si ato që po orvatej t'i rregullojë në Kosovë, mosbesimi i vazhdueshëm ndaj misionit nga qytetarët e Kosovës është i kuptueshëm.

Në mënyrë të ngjashme, në 2016, edicioni i gjashtë i BKS-së raportoi se vetëm 20% e qytetarëve i besonin misionit të EULEX-it, me skandalet e korrupsionit të vitit 2014 dhe 2015 duke treguar një efekt të zgjatur. Qytetarët gjithashtu raportuan përsëri shqetësimin se korrupsioni mbetet i pranishëm në sistemin e drejtësisë së Kosovës, duke treguar që EULEX-i ende nuk po arrinte të realizojë misionin e vet.²⁰ Edicioni i shtatë i BKS-së i botuar në fillim të vitit 2018 raportoi se vetëm 24% e të anketuarve i besonin EULEX-it. Sidoqoftë, ky raport gjithashtu zbërtheu nivelet e besimit sipas rajonit dhe sipas përkatësisë etnike, duke gjetur nivele të ulëta të besimit në radhët e pakicës serbe kosovare dhe në rajonin e Mitrovicës së Veriut.²¹ Mosbesimi i rritur në këtë rajon ka të ngjarë të jetë për shkak të marrëveshjes paraprake të lidhur ndërmjet zyrtarëve të EULEX-it dhe Serbisë që përcaktonte se asnjë zyrtar ligjor shqiptar nuk do të mund të punonte në rastet e EULEX-it

17 QKSS, *Barometri Kosovar i Sigurisë, Edicioni i pestë*, 2015. <http://www.qkss.org/repository/docs/Barometri_Kosovar_i_Sigurise_-_edicioni_i_pestë_621222.pdf>

18 Julian Borger, 'EU's biggest foreign mission in turmoil over corruption row'. The Guardian, 5 nëntor 2014. <<https://www.theguardian.com/world/2014/nov/05/eu-facing-questions-dismissal-prosecutor-alleged-corruption>>.

19 Jean-Paul Jacqué, 'Review of the EULEX Kosovo Mission's Implementation of the Mandate with a Particular Focus on the Handling of Recent Allegations', 2015. <https://www.eulex-kosovo.eu/eul/repository/docs/150331_jacqué-report_en.pdf>.

20 QKSS, *Barometri Kosovar i Sigurisë, Edicioni i gjashtë*, 2016. <http://www.qkss.org/repository/docs/BKS_edicioni_i_gjashte_498642.pdf>.

21 QKSS, *Barometri Kosovar i Sigurisë, Edicioni i shtatë*, 2018. <http://www.qkss.org/repository/docs/KOSOVO_SECURITY_BAROMETER_7_SHOIP_FINAL_163414.pdf>.

në Mitrovicën e Veriut, siç raportohet nga James Hargreaves, gjyqtar amerikan i cili për një kohë shërbeu në kuadër të misionit në Kosovë.²² Në fund të vitit 2018, besimi, ose mungesa e tij, ndaj EULEX-it mbeti i njëjtë me 24%.²³

Nga analiza e edicioneve të shumta të BKS-së dhe e burimeve të tjera, janë gjetur disa tema që vazhdimisht dalin si faktor lidhur me mungesën e besimit të publikut kosovar ndaj EULEX-it. Me sa duket, një nga shqetësimet më të mëdha është se përkundër pranisë së EULEX-it në Kosovë për një dekadë, nuk ka ulje të korrupsionit si në Qeveri ashtu edhe në institucionet ligjore në Kosovë dhe në të vërtetë vetë EULEX-i dukej se ishte i korruptuar. Megjithëse EULEX kishte premtuar se ata do të siguronin që institucionet e sundimit të ligjit do të ishin pa ndërhyrje politike, kishte prova që kjo ende po ndodhte. Nga përvoja e tij personale, Hargreaves kishte qenë dëshmitar që gjyqtarët mendonin se qoftë ata vetë ose familja e tyre do të ndëshkoheshin nëse do të shpallnin dënimin në raste të caktuara²⁴. Kjo sugjeron që në vitin 2014, pas 5 viteve të pranisë së EULEX-it në Kosovë, ende kishte një nivel të lartë të përfshirjes politike në institucionet e sundimit të ligjit. Siç u përmend më herët në raport, të anketuarit vazhdimisht mendonin se ende kishte nivele të larta të korrupsionit, dhe perceptimi i publikut mbështetet nga Indeksi i Perceptimit të Korrupsionit i Transparency International i cili tregon se ndërmjet 2011 dhe 2019 kishte një përmirësim prej vetëm dy pikësh në nivelin e korrupsionit në Kosovë.²⁵ Për misionin më të madh civil të BE-së, kjo është padyshim një arritje e dobët. Për shembull, një burim ka deklaruar gjithashtu se mesatarisht një gjyqtar i EULEX-it zgjidh 0.17 raste korrupsioni çdo vit dhe 0.07 raste të krimit të organizuar²⁶ që është pa dyshim një performancë e dobët sidomos kur merren parasysh rastet e pretenduara të rryshfetit dhe korrupsionit brenda vetë EULEX-it.

Një arsye tjetër e mundshme për mungesën e besimit të publikut kosovar është ajo që u përmend gjatë vendosjes së EULEX-it në kontekst, dhe kjo është se EULEX-i u vendos si një mision asnjans rreth statusit për të pasqyruar dallimet e opinioneve ndërmjet anëtarëve të BE-së. Megjithatë, përkundër kësaj, pakica e serbëve të Kosovës ka edhe më pak besim ndaj misionit sesa shqiptarët kosovarë, sipas edicionit të gjashtë të KSB-së, meqë ata e kritikojnë atë që është pro-pavarësisë së

22 James Hargreaves, *The EULEX Legacy in the Kosovo Courts*, 2014. <<https://www.balkanicaucaso.org/eng/Areas/Kosovo/The-EULEX-Legacy-in-the-Kosovo-Courts-156872>>.

23 QKSS, *Barometri Kosovar i Sigurisë, Edicioni i tetë*, 2018. <http://www.qkss.org/repository/docs/barometri2018-SHQIP_853983.pdf>.

24 James Hargreaves, *The EULEX Legacy in the Kosovo Courts*, 2014. <<https://www.balkanicaucaso.org/eng/Areas/Kosovo/The-EULEX-Legacy-in-the-Kosovo-Courts-156872>>.

25 Transparency International, *Corruption Perception Index: Kosovo*, 2019. <<https://www.transparency.org/en/cpi/2019/results/ksv>>.

26 Selvije Bajrami, 'The Rule of Law in Kosovo: Mission Impossible?'. *Balkan Insight*, 17th November 2011. <<https://balkaninsight.com/2011/11/17/the-rule-of-law-in-kosovo-mission-impossible/>>.

Kosovës dhe për shkak se nuk ka ndjekur penalisht krimet kundër serbëve të Kosovës. Si rezultat, ekziston një mosbesim i të dyja palëve ndaj EULEX-it edhe pse jo gjithmonë për të njëjtat arsye.

Në të vërtetë, një përmbledhje e intervistave të raportuara nga Mahr në vitin 2017 zbuloi se shumë shqiptarë të Kosovës dhanë refuzimin e EULEX-it për të pranuar pavarësinë e tyre si faktor kontribuues në kontestimin e misionit në vend, duke përfshirë një protestë në shkallë të gjerë nga Lëvizja Vetëvendosje.²⁷ Veriu i Kosovës gjithashtu dëshmoi se ishte një faktor rreth të cilit nuk u pajtuan shqiptarët dhe serbët brenda Kosovës. Serbia ushtron kontroll në pjesën veriore të Kosovës për shkak se rajoni është i banuar me shumicë nga serbët e Kosovës, por së këndejmi Kosova konsideron çështje jetike dështimin e vazhdueshëm të EULEX-it për të vendosur një sistem të sundimit të ligjit në veri pa ndërhyrjen serbe. Në anën tjetër, shqiptarët e Kosovës dhe serbët e Kosovës theksojnë si pikë të animeve edhe gjykimet e ish-pjesëtarëve të UÇK-së nga ana e EULEX-it. Shqiptarët e Kosovës i shohin anëtarët e UÇK-së si heronj të luftës (megjithëse jo medoemos të paqes) dhe dënojnë prokurorinë e EULEX-it për dështimin e ndjekjes penale të kriminelëve serbë të luftës, ndërsa serbët e Kosovës shprehin besimin se EULEX-i është 'pro-shqiptar' për shkak të joefikasitetit në parandalimin dhe hetimin e sulmeve nga shqiptarët e Kosovës.²⁸

Përveç që nuk i ka rregulluar çështjet që ishte paraparë t'i rregullonte, EULEX-i gjithashtu ka fituar reputacionin se ka pak kontakt me qytetarët të cilëve në fund të fundit orvatet t'iu ndihmojë, dhe që është shpërfillës ndaj qytetarëve me të cilët ka kontaktuar. Ndërsa faqet e internetit të EULEX-it janë përplot me raporte të takimeve dhe donacioneve, ka përvoja të dorës së parë nga personat që kanë marrë pjesë në ato takime që tregojnë se ngjarjet kanë rrjedhë ndryshe. Një burim që kishte pasur përvojë të kontaktit të dorës së parë me EULEX-in përshkroi takimet në të cilat ai kishte marrë pjesë ku dukej se zyrtarët e EULEX-it dëshironin që pjesëmarrësit të ndiqnin njëfarë skenari dhe, kur u përballën me çështjet dhe rezultatet e BKS-së, ata deklaruan se u duhej kohë për të përmbushur misionin e tyre.²⁹ Kjo shtrihet pyetjen: a po qëndron EULEX-i në Kosovë më gjatë sepse nuk dëshiron që misioni i tij i gjatë dhe jashtëzakonisht i shtrenjtë të konsiderohet si dështim? A po qëndron EULEX-i në Kosovë vetëm për të shpëtuar fytyrën? Në këtë moment, kur misioni i tij është zgjatur vetëm për një vit shtesë, me sa duket nuk ka gjasa që të bëhet ndonjë përmirësim domethënës. Shikuar historikisht, EULEX-i gjithashtu ka pasur fare pak kontakte me publikun kosovar. Grafiku i mëposhtëm tregon se sa të anketuar të BKS-së raportuan se kishin


27 Ewa Mahr, 'Local contestation against the European Rule of Law Mission in Kosovo'. *Contemporary Security Policy*, vol 39 issue 1 (2018), pp 72-94.

28 Ewa Mahr, 'Local contestation against the European Rule of Law Mission in Kosovo'. *Contemporary Security Policy*, vol 39 issue 1 (2018), pp 72-94.

29 Dr Florian Qehaja, 'Why EULEX should have been phased out a long time ago', 2020. <<https://sbunker.net/oped/90556/why-eulex-should-have-phased-out-a-long-time-ago/>>.

kontakte me EULEX-in nga edicioni i tretë në dhjetor 2013 deri në edicionin e pestë – e vetmja periudhë kur BKS raportoi për nivelet e kontaktit.³⁰

Të anketuarit që raportojnë kontakte me EULEX-in (%)




Një krahasim interesant mund të bëhet ndërmjet EULEX-it dhe një pranije tjetër ndërkombëtare në Kosovë: Forca e Kosovës, ose KFOR, ka ofruar praninë e NATO-s në Kosovë që nga viti 1999. Në të gjitha edicionet e BKS-së që raportojnë mbi këtë temë, KFOR-i në vazhdimësi gëzon më shumë besim publik sesa EULEX-i. Për ko incidencë, ai gjithashtu ka pasur më shumë kontakte me publikun. Edhe pse aktualisht ky është një faktor korrelacioni dhe ende nuk mund të dëshmohej si shkak, mungesa e kontakteve të EULEX-it me publikun mund të jetë një faktor kontribuues për mungesën e besimit. Në fakt, nga artikujt e shumtë në uebsajtin e EULEX-it mund të vihet në përfundim se krahas niveleve të raportuara të kontaktit me publikun vendas, zyrtarët e përfshirë në mision janë më të preokupuar me mënyrën si komuniteti ndërkombëtar e sheh misionin sesa që janë të preokupuar me pikëpamjet e publikut kosovar. Niveli më i lartë i besimit ndaj KFOR-it nënkupton gjithashtu se çështja nuk qëndron te fakti që misioni realizohet nga bashkësia ndërkombëtare: çështja qëndron te veprimet specifike që i ka bërë EULEX-i përgjatë pranisë së tij në Kosovë. Vitet kur besimi i publikut ka

³⁰ Statistikat e marra nga edicionet dhe vitet përkatëse të Barometrit Kosovar të Sigurisë.

rënë ndjeshëm korrespondojnë me skandalet në mision. Në edicionin e BKS-së për vitin 2012, pjesëtarët e publikut kosovar gjithashtu komentuan se ata mendonin që KFOR-i ishte më pak i njëanshëm sesa EULEX-i.

Kur u pyetën për të ardhmen e EULEX-it dhe nëse ai do të duhej të mbetet në Kosovë, megjithëse disa të anketuar u shprehën se EULEX-i nuk do të duhej të largohet kurrë, shumica e të anketuarve shprehën mendimin se koha e EULEX-it në Kosovë do të duhej të jetë e kufizuar, dhe se EULEX-i do të duhej të largohet brenda disa viteve të ardhshme. Grafiku vijues është marrë nga edicioni i BKS-së për vitin 2015:³¹

Përceptimet e qytetarëve në lidhje me të ardhmen e misionit të EULEX (BKS15)



Kur merret parasysh besimi i ulët ndaj misionit, fakti që shumica dërrmuese e të anketuarve ishin në favor të largimit të EULEX-it nga Kosova është i kuptueshëm. Ky grafik është bërë gjithashtu para pesë vjetësh dhe për këtë arsye të anketuarit asokohe besonin se deri në këtë vit (2020), EULEX-i do të duhej të ishte larguar.

Duke marrë parasysh të gjitha analizat, me nivelin e ulët të besimit nga publiku, korrupsionin brenda vetë misionit dhe dështimin për të korrë sukses, vihet në dyshim nëse EULEX-i ka ende mandat që të veprojë në Kosovë, meqë mbështetja e publikut është faktor i madh kontribuues për vazhdimin e mandatit të një misioni ndërkombëtar si ky dhe arsyet e EULEX-it për të mbetur në Kosovë po ashtu mund të vihen në dyshim.

31 Grafiku është marrë nga edicioni i vitit 2015 i BKS-së.

PËRFUNDIM

Misioni i EULEX-it në Kosovë kishte për synim të ndihmojë në ndërtimin e institucioneve jo të korruptuara të Sundimit të Ligjit pa ndërhyrje politike dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare, i mbështetur me buxhet të madh dhe numër të madh të personelit, i cili numër u ul me kalimin e kohës. Ai është i pranishëm në Kosovë për më shumë se një dekadë (që nga viti 2008), porse ka pasur pak përmirësim të prekshëm dhe misionit i mungon besimi nga publiku kosovar, i cili mbase është grupi më i rëndësishëm besimin e të cilit duhet ta fitojë misioni në mënyrë që të ketë një arsye të ligjshme për të mbetur në vend.

Gjatë kohës së EULEX-it në Kosovë korrupsioni ka mbetur në nivele të qëndrueshme në Indeksin e Transparencës, gjë që sugjeron fort se nuk ka pasur përmirësime në atë që publiku i Kosovës e konsideron si kërcënim të rrezikshëm për sigurinë e brendshme. Ka pasur edhe skandale të shumta në lidhje me marrjen e ryshfetit kur është vendosur për aktgjykimet e lëndëve, apo edhe kur është vendosur nëse dikush duhet të ndiqet penalisht. Për më tepër, EULEX-i nuk ka bërë ndonjë përpjekje të madhe për të komunikuar me publikun vendas, të cilët kanë raportuar se kanë shumë pak kontakte me misionin në krahasim me misionet e tjera ndërkombëtare të pranishme në Kosovë, siç është KFOR-i. Kur EULEX-i ka mbajtur takime, e ka bërë këtë për qëllime informative dhe jo për të diskutuar dhe shqetësimet e shprehura u hodhën poshtë me arsyetimin se 'kanë nevojë për më shumë kohë'.

Potencialisht, hapja e linjave të komunikimit do të mund të ndihmonte në rritjen e besimit të publikut dhe EULEX-i do të duhej të punojë për të fituar besimin e publikut duke rritur komunikimin e dyanshëm dhe duke dëgjuar brengat e qytetarëve të cilëve ata po orvaten t'i ndihmojnë në fund të fundit. Ekziston gjithashtu nevoja për kërkime të mëtejshme parësore për arsyet e sakta pse publiku i Kosovës ka aq pak besim ndaj EULEX-it, meqë burimet parësore deri më tani kanë qenë të pakta. Kërkimet do të mund të përfshinin një zbrëthim më të hollësishëm për dallimet lidhur me besimin e publikut midis misioneve ndërkombëtare dhe dallimet midis etnive të ndryshme në Kosovë, meqë BKS ka treguar se për sa i përket besimit ka dallime midis etnive. Ndërkohë, BKS do të duhej të vazhdojë të përcjellë besimin e publikut ndaj misionit për sa kohë që misioni mbetet në Kosovë, megjithëse sipas mandatit aktual ai do të marrë fund në 2021.

BIBLIOGRAFIA

- Aliu, F. (2012). 'EU Kosovo Mission Fights Back Against Critics'. *Balkan Insight* [online]. Në dispozicion këtu: <https://balkaninsight.com/2012/06/14/eulex-fights-back-to-critics/>
- Bajrami, S. (2011). The Rule of Law in Kosovo: Mission Impossible?. *Balkan Insight* [online], 17 nëntor 2011. Në dispozicion këtu: <https://balkaninsight.com/2011/11/17/the-rule-of-law-in-kosovo-mission-impossible/>
- Balkans Policy Research Group. (2019). Raport i Politikave: Një DEKADË pas EULEX-it. [online] Në dispozicion këtu: https://balkangroup.org/wp-content/uploads/2020/01/Nje-dekade-pas-eulexit_qasje-e-re-per-ta-permiresuar-sundimin-e-ligjit-ne-kosove.pdf
- Borger, J. (2014). 'EU's biggest foreign mission in turmoil over corruption row'. *The Guardian* [online], 5 nëntor 2014. Në dispozicion këtu: <https://www.theguardian.com/world/2014/nov/05/eu-facing-questions-dismissal-prosecutor-alleged-corruption>
- de Wet, E. (2009). The Governance of Kosovo: Security Council Resolution 1244 and the Establishment and Functioning of Eulex. *American Journal of International Law*, 103(1), p.83.
- EULEX. (2012). *EULEX Mission Extended until June 2014*. [online] Në dispozicion këtu: <https://www.eulex-kosovo.eu/en/news/000368.php>.
- European Court of Auditors. (2012). *European Union Assistance to Kosovo Related to the Rule of Law*. [online] Në dispozicion këtu: https://www.eca.europa.eu/Lists/ECADocuments/SR12_18/SR12_18_EN.PDF.
- EWB. (2020). *EULEX mandate in Kosovo extended for another year*. [online] European Western Balkans. Në dispozicion këtu: <https://europeanwesternbalkans.com/2020/07/13/eulex-mandate-in-kosovo-extended-for-another-year/>
- Greïçevci, L. (2011). EU Actorness in International Affairs: The Case of EULEX Mission in Kosovo. *Perspectives on European Politics and Society*, 12(3), pp.283–303.
- Hargreaves, J. (2014). *The EULEX Legacy in the Kosovo Courts*. [online] Në dispozicion këtu: <https://www.balcanicaucaso.org/eng/Areas/Kosovo/The-EULEX-Legacy-in-the-Kosovo-Courts-156872>.
- Jacqué, JP. (2015). *Review of the EULEX Kosovo Mission's Implementation of the Mandate with a Particular Focus on the Handling of Recent Allegations*. [online] Në dispozicion këtu: https://www.eulex-kosovo.eu/eul/repository/docs/150331_jacque-report_en.pdf.
- QKSS. (2012). *Barometri Kosovar i Sigurisë*. [online] Në dispozicion këtu: http://www.qkss.org/repository/docs/Kosovo_Security_Barometer_Report_Shqip_935713.pdf
- QKSS. (2013). *Barometri Kosovar i Sigurisë, Edicioni i tretë*. [online] Në dispozicion këtu: http://www.qkss.org/repository/docs/Barometri_Kosovar_i_Sigurise_Edicioni_i_Trete_374655.pdf

- QKSS. (2013). *Barometri Kosovar i Sigurisë, Zërat e Kosovës: Vështrimet dhe Perceptimet*. [online] Në dispozicion këtu: http://www.qkss.org/repository/docs/Barometri_Kosovar_i_Siguirs%C3%AB_Z%C3%ABrat_e_Kosov%C3%ABs-V%C3%ABshtrimet_dhe_P%C3%ABrceptimet_864612.pdf
- QKSS. (2014). *Barometri Kosovar i Sigurisë, Edicioni i katërt*. [online] Në dispozicion këtu: http://www.qkss.org/repository/docs/Barometri_Kosovar_i_Sigurise_-_Edicioni_i_katert_515028.pdf
- QKSS. (2015). *Barometri Kosovar i Sigurisë, Edicioni i pestë*. [online] Në dispozicion këtu: http://www.qkss.org/repository/docs/Barometri_Kosovar_i_Sigurise_-_edicioni_i_pestë_621222.pdf
- QKSS. (2016). *Barometri Kosovar i Sigurisë, Edicioni i gjashtë*. [online] Në dispozicion këtu http://www.qkss.org/repository/docs/BKS_edicioni_i_gjashte_498642.pdf.
- QKSS. (2018a). *Barometri Kosovar i Sigurisë, Edicioni i shtatë*. [online] Në dispozicion këtu http://www.qkss.org/repository/docs/KOSOVO_SECURITY_BAROMETER_7_SHQIP_FINAL_163414.pdf.
- QKSS. (2018b). *Barometri Kosovar i Sigurisë, Edicioni i tetë*. [online] Në dispozicion këtu: http://www.qkss.org/repository/docs/barometri2018-SHQIP_853983.pdf
- Kursani, S. (n.d.). A Comprehensive Analysis of EULEX: What Next? *www.academia.edu*. [online] Në dispozicion këtu: https://www.academia.edu/8298704/A_Comprehensive_Analysis_of_EULEX_What_Next
- Mahr, E. (2017). Local contestation against the European Union Rule of Law Mission in Kosovo. *Contemporary Security Policy*, 39(1), pp.72–94.
- Proksik, J.J. (2017). EULEX and the fight against organised crime in Kosovo: what's the record? *Trends in Organized Crime*, 21(4), pp.401–425.
- Qehaja, F. (2020) *Why EULEX should have been phased out a long time ago*. [online] Në dispozicion këtu: <https://sbunker.net/op-ed/90556/why-eulex-should-have-phased-out-a-long-time-ago/>.
- Radin, A. (2014). Analysis of current events: "towards the rule of law in Kosovo: EULEX should go." *Nationalities Papers*, 42(2), pp.181–194.
- Spernbauer, M. (2010). EULEX Kosovo: The Difficult Deployment and Challenging Implementation of the Most Comprehensive Civilian EU Operation to Date. *German Law Journal*, 11(7–8), pp.769–802.
- Transparency International. (2019). *Corruption Perception Index: Kosovo*. [online] Në dispozicion këtu: <https://www.transparency.org/en/cpi/2019/results/ksv>.
- www.eulex-kosovo.eu. (n.d.). *EULEX - Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë*. [online] Në dispozicion këtu: <https://www.eulex-kosovo.eu/?page=2>.

Katalogimi në botim – (CIP)

Biblioteka Kombëtare e Kosovës "Pjetër Bogdani"

061.1: 32(496.51)(047)

Rose, Emma-Louise

Legitimising external missions: Deconstructing citizens' perceptions towards EULEX in Kosovo / Emma-Louise Rose. - Prishtinë : Kosovar Centre for Security Studies, 2020. – 20 f. : ilustr. ; 21 cm.

ISBN 978-9951 -799-11-9

www.qkss.org

ISBN 978-9951-799-11-9



9 789951 799119